



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 30.6.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Milena Miliqeviq, Danush Ademi, Doruntinë Maloku.

Munguan: Fatmir Limaj, Agim Ademaj, Selvije Halimi dhe Nezir Çoçaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hamit Mjeku- praktikant në Kuvend; Zahir Çerkini- praktikant në Kuvend; Kaltrina Ahmeti- GLPS; Tringa Bytyçi- GLPS; Driton Selmanaj- KDI; Arta Krasniqi- OSBE; Gentiana Dushi- Praktikante; Edi Pirana- praktikant; Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office; Leonora Aliu- Koha Ditore

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Albulena Haxhiu, kryetare theksoi se nëse Komisioni pajtohet sot, atëherë do ta procedojmë këtë projektligj për mendim në Qeveri, dhe pas miratimit të këtij projektligji në Komision, do të përgatitet edhe deklarata financiare, në mënyrë që të plotësohen kushtet formale që janë të parapara me rregulloren e Kuvendit dhe me pas të shkojë për mendim në Qeveri.

Ne e dimë rendësinë e këtij Ligji, por kam disa vërejtje që do ti paraqes në këtë projektligj si amendamente pas kthimit nga Qeveria.

Armend Zemaj theksoi se edhe një ditë më parë ishin të gatshëm ta procedojnë për Qeveri, mirëpo për shkak të kërkesës së deputetëve tjerë, që ta kenë draftin që ta rishikojnë deri sot, ky draft duhet të përcillet kështu siç është. Duhet theksuar se e kemi rregulluar raportin me MSA-në, pavarësinë e teknologjisë informative dhe dy- tri elemente që kanë dal si çështje procedurale. Z. Danush Ademi ka kërkuar që moshë e pensionimit të deputetit të jetë 60 vjet dhe shkallët e pensionit të deputetit i ka cilësuar si diskriminuese për ata që kanë më shumë mandate, mirëpo, një pajtim i përgjithshëm ka qenë që të mbetet kështu siç është tani, duke mos harruar se e kemi hequr edhe pensionin familjar. Kosto buxhetore është e përballeshme sepse kemi rritur moshën e pensionimit. Vetëm duhet saktësuar aktet e miratuara nga Kuvendi.

Kryetarja theksoi se pajtohet me formulimin e akteve të cilat i nxjerr Kuvendi, mirëpo jo me përkufizimin e Rezolutës, andaj propozim imi tha ajo, është që *Rezoluta është një akt ligjërishit detyrues i miratuar nga Kuvendi, i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit dhe e botuar në Gazetën zyrtare*. Po ashtu, nuk pajtohet me pagën e deputetëve andaj propozim i imi dhe i subjektit të ciline përfaqësoi është që deputeti të ketë vetëm pagën e jo dhe shtesat.

Xheladin Hoxha- Theksoi se tek ne termi rezolutë ka të bëjë me vendimet, siç janë: Vendim për miratimin e rregullores, vendim për emërime, vendim për vendimmarrje, andaj nëse dëshironi ta ndryshoni, duhet ndryshuar përkufizimi i vendimit dhe i rekomandimit si dhe i akteve tjera e më pas me futë rezolutën.

Armend Zemaj propozoi që të miratohet teksti pa këtë amendament, dhe më pas që ta procedojmë për deklaratë financiare, pasi që ky nen nuk ka implikime buxhetore.

Kryetarja pas përfundimit të diskutimeve kërkoi që të përgatitet deklarata financiare, gjithashtu Drejtoria për Hulumtim dhe Standardizim, që të angazhohet për ta sjellë një definicion të qartë për secilin akt që nxjerr Kuvendi, që përcaktohet në nenin 5 të Projektligjit dhe në mbledhjen e radhës e procedojmë sipas nenit 55, të rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
